



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 544/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.08.2019, shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik “Alstezo” sh.a. në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-19847-04-26-2019, me objekt: “Loti 2 Blerje bateri për automjete”, me fond limit 10.405.535,83 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 23.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara”.
“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me operatorët ekonomikë të kualifikuar “Alfred Kopaçi” p.f., “Kadiu” sh.a. dhe “Ra – Mi Kompany” sh.p.k., pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit”.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Alstezo” sh.a.
Lagjja “Kryengritja e Fierit”, Rruga “Aulona”, Fier
- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara
Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë
- Subjekte të interesuara:** Operatori ekonomik “Alked Kopaçi” p.f.
Rruga e Kavajës, Pallati nr. 102, Shkalla nr. 1, Tiranë

Operatori ekonomik “Kadiu” sh.a.
Autostrada Tiranë – Durrës, Km 3
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30.04.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-19847-04-26-2019, me objekt: “*Loti 2 Blerje bateri për automjete*”, me fond limit 10.405.535,83 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 23.05.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (vlera e ofertës, shumatorja e çmimeve për njësi pa TVSH) përkatësisht:

- | | |
|------------------------------|-----------------------------------|
| 1. “Alked Kopaçi” p.f. | 273.500 lekë, kualifikuar |
| 2. “Kappa – Oil” sh.p.k. | 298.100 lekë, skualifikuar |
| 3. “Kadiu” sh.a. | 307.167 lekë, kualifikuar |
| 4. “Alstezo” sh.a. | 325.800 lekë, skualifikuar |
| 5. “Ra – Mi Kompani” sh.p.k. | 334.775 lekë, kualifikuar |
| 6. “Arblev” sh.p.k. | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

II.3. Në datën 06.06.2019 operatori ekonomik “Alstezo” sh.a. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyet si më poshtë vijon:

- *Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 6 të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 9 të DT-së. Dokumenti i datës 21.05.2019 i lëshuar nga “LUBATEX GROUP” për ofertuesin ALSTEZO SHA, është autorizim i lëshuar nga një distributor për këtë procedurë prokurimi, por në këtë rast nuk është vertetuar me dokumentacion lidhja midis distributorit – “LUBATEX GROUP” dhe prodhuesit të baterive të ofertuara, konkretisht ‘VARTA AG’. Në dokumentin e paraqitur si autorizim nuk ka të dhëna të plota të prodhuesit të baterive “VARTA” si tel, email ëëbsite të nevojshme këto në rast verifikimi.*

II.4. Në datën 13.06.2019, operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, ku kundërshton skualifikimin e ofertës së tij, si edhe ngre pretendime në lidhje me operatorët e tjerë ekonomikë të kualifikuar në këtë procedurë prokurimi.

Konkretisht operatori ekonomik ankimes pretendon se:

[...]

E kundërshtojme këtë klasifikim pasi është bërë në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik ndërkohë që ne si operator ekonomik i plotësojmë të gjitha kërkesat e vendosura nga AK në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, si dhe kemi rezervat tona për klasifikimin në teresi të Operatoreve në këtë procedurë prokurimi.

Konkretisht, ankimin tonë e mbështesim në argumentimin, si vijon:

Në Shtojcën 9, Loti II “Blerje bateri për automjete”, pika 2 Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kërkohej midis të tjerash:

2.3 Kapacitetin teknik:

6. Operatori ekonomik duhet të provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për këtë objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

7. Operatori ekonomik të paraqesë katalogë/ broshurë të baterive, ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar) Në katalogë/ broshura duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) artikujt bateri dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 10 të DST. Katalogët/broshurat duhet të shoqërohen me një listë të baterive sipas tabelës së përgjithshme (shtojca 12) ku të specifikohen të dhënat si vijon:

Nr.	Emertimi i artikullit (Baterisë)	Njësia	Sasia	Emërtimi kompanisë prodhuese	Emërtimi i katalogut	Numri i faqes në katalog	Part-Number i prodhuesit	Standarti i Cilësisë

Sa me sipër, në lidhje me pikën 2.3/6 në plotësim të saj në kemi paraqitur Autorizimin e prodhuesit dhe jo distributori, sikurse pretendohet nga AK leshuar nga “LUBATEX GROUP” me datë 21.05.2019 pikerisht për këtë procedurë prokurimi. Në këtë autorizim janë të evidentuara shumë qarte “të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, Ëëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij”.

Pasqyrimi i marrëdhënieve të prodhuesit dhe katalogut, shprehet shumë qarte në tabelën e cila është bërë edhe në plotësimin e kriterit në pikën 2.3/7 ku thuhet që prodhuesi është “LUBATEX GROUP”, por katalogu është VARTA.

Sqarojme KVO që VARTA në vetevetë nuk është Fabrikë prodhuese, por është një emër (BRAND) baterie, sikurse është Freebatt, Energizer, Everkraft, OPTIMA etj të cilat janë “BRAND” të prodhuara dhe furnizuara tek në nga “LUBATEX GROUP”.

(bashkëngjitur po ju dergojmë të ilustruar edhe mënyrën se si mund futeni në faqen Ëëbsite të “LUBATEX GROUP” (ëëë.lubatexgroup.com) nga ku ju mund të shikoni qarte të gjitha markat e trajtuara nga kjo kompani.)

Pra pretendimi i AK për mosplotësim të këtij kriteri nga ana jone NUK QENDRON

Nderkohe, nisur nga gjykimi i mesipër i KVO-se, lidhur me klasifikimin e ofertave si dhe nga informacionet që kemi për konkurentet tane të cilët kanë ofertuar në këtë procedurë prokurimi, nxjerrim konkluzionin se AK nuk është thelluar në verifikimin e plote të dokumentacionit që ata kanë paraqitur se bashku me ofertën e tyre në këtë procedurë prokurimi, gjë e cila ka ndodhur edhe në rastin e vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur se bashku me ofertën tona në këtë procedurë prokurimi.

Perfundimisht bazuar në Nenin 27 të VKM 914 datë 29.12.2014 për Rregullat e Prokurimit Publik i ndryshuar, kërkojmë rivlerësim të ofertave të OE pjesmarres në këtë procedurë prokurimi si dhe riklasifikim nga KVO. Pasi të rishikohet edhe njëherë dokumentacioni i tyre, të behet klasifikimi i ofertës tona si një ofertë që i ka plotësuar të gjitha kërkesat e vendosura nga AK në Kushtet e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3/6 dhe 2.3/7 për këtë objekt prokurimi.

II.5. Me shkresën nr. 1082/1 prot., datë 20.06.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke mos e pranuar ankesën, ndërkohë që operatori ekonomik ankimues pretendon se është njohur me kthim përgjigje në datën 21.06.2019 nëpërmjet sistemit elektronik (email), ndërsa në rrugë postare vërteton me dokument postar se ankesa është depozituar pranë shoqërisë së tij në datën 28.06.2019, duke pretenduar se ankesa është shqyrtuar dhe kthyer përgjigje jashtë afatit 7 ditor të përcaktuar në ligj.

II.6. Në datën 01.07.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kundërshtuar skualifikimin e tij, si edhe ngre pretendime në lidhje me operatorët e tjerë ekonomikë të kualifikuar në këtë procedurë prokurimi.

Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon se:

Kemi marrë pjesë në procedurën e e Prokurimit Publik me Objekt Lotin II "Blerje bateri për automjete", fondi limit i marrëveshjes kuadër është 10.405.535,83 lekë pa TVSH zhvilluar me datë 23.06.2019.

Ne datën 06.06.2019 jemi njohur nepermjet SPE ne faqen e APP me klasifikimin e ofertave, ku ne si Operator Ekonomik jemi skualifikuar me arsyetimin, si me poshtë:

“Ofertuesi nuk ploteson kriterin e percaktuar ne piken 6 te seksionit 2.3 “kapaciteti teknik” te Shtojces 9 te DT . Dokumenti i dates 21.05.2019 i leshuar nga “LUBATEX GROUP” per Ofertuesin ALSTEZO SHA, eshte Autorizim i leshuar nga distributori per kete procedure prokurimi, por ne kete rast nuk eshte vertetuar ne dokument lidhja midis distributorit “LUBATEX GROUP” dhe prodhuesit te baterive te ofertuara, konkretisht “VARTA AG”. Ne dokumentin e paraqitur si autorizim nuk ka te dhena te plota te prodhuesit te baterive “VARTA AG” si nr. Tel, e_mail, ëëbsite te nevojshme keto ne rast verifikimi.”

[...]

Ne datën 13.06.2019 protokolluam ankesen prane autoritetit kontraktor ku ne ankesen drejtuar AK pretenduam si me poshte:

[...].

Ne datën 21.06.2019 jemi njohur me email me shkresen nr. 1092/1 prot., date 20.06.2019 te autoritetit kontraktor (kthimi i pergjigjes se AK eshte jashte afatit 7 ditor te shqyrtimit te ankeses sipas nenit 63 te LPP), ku ankesa jone nuk eshte pranuar. Nderkohe, e njejta pergjigje e AK, ka ardhur me poste me shkrim....

Ne lidhje me kthimin e pergjigjes duam te sqarojme se:

Ashtu sic kemi sqaruar edhe ne ankesen e paraqitur ne AK nga shoqeria jone eshte paraqitur autorizim i prodhuesit ashtu sic eshte kerkuar ne dokumentat e tenderit dhe jo autorizimi i distributorit sic pretendon autoriteti kontraktor.

Kemi sqaruar qe ne tender ne SPE kemi futur dokumentin Autorizim i Prodhuesit Lubatex Group si prodhues, i cili ofron dhe garanton disponueshmerine e furnizimit te gjithë games se artikujve te Lubatex Group per shoqerine Alstezo si distributor ekskluziv i prodhuesit Lubatex Group kjo referuar dokumentit Autorizim Prodhuesi.

Nuk kuptojme arsyen e skualifikimit te AK si edhe kthimin e pergjigjes pas shqyrtimit te ankeses sone qe citon se dokumenti i leshuar nga Lubatex Group eshte dokument i leshuar nga nje distributor, si edhe se kuptojme se ku e bazon kete fakt te pretenduar prej saj sepse nuk jep asnje fakt dhe prove per kete pretendim.

Ne lidhje me pretendimin e AK se ne dokumentin e paraqitur si autorizim nuk ka te dhena te plota te prodhuesit te baterive “VARTA AG” si nr. Tel e_mail, **ëëbsite** te nevojshme keto ne rast verifikimi”, sqarojme se ne kete dokument te leshuar ne datën 21.05.2019 pikerisht per kete procedure prokurimi nga shoqeria Lubatex Group jane percaktuar te gjitha te dhenat e kerkuara nga AK ne dokumentat e tenderit te cilat i nevojiten AK per verifikimin e tyre (nr. Tel, email, ëëbsite, adrese etj) te dhena te mjaftueshme per AK.

Nuk e kuptojme kete logjike te AK per mungese te dhenash te prodhuesit si nr. Tel, etj. kur te gjitha te dhenat jane te pasqyruara ne autorizimin e prodhuesit te paraqitur nga ana jone dhe shume lehte mund te verifikohen ne kete dokument.

Autorizimi i prodhuesit i leshuar nga Lubatex Group, i cili eshte nje dokument i rregullt qe permban te gjitha te dhenat e kerkuara nga AK ne DS.

Duam te sqarojme edhe njehere se ne kemi paraqitur edhe dokumentin e kerkuar nga AK ne piken 2.3/7 te DST, pra dokumentin me tabelen ne te cilen eshte pasqyruar marredhenia e prodhuesit dhe katalogut ku eshte deklaruar se prodhuesi eshte Lubatex Group dhe katalogu eshte Varta.

Varta nuk eshte prodhues apo fabrike prodhuese ne vetvete ashtu sic e kemi thene edhe me lart por nje brand baterie si edhe llojet e tjera te baterive Freebatt, Energizer, Everkraft, Optima etj te cilat jane “brand” baterish te prodhuara dhe furnizuara tek shoqeria jone nga Lubatex Group.

Gjithashtu mund te beni verifikime lehtesisht te te gjitha ketyre qe sqaruam ne faqen e saj ëëë.lubatexgroup.com, ku mund te verehen shume qarte te gjitha markat e baterive qe trajtohen nga kjo kompani.

AK nuk mund te ngreje pretendime apriori per shoqerine tone pa fakte e argumenta duke dhene si arsye skualifikimi se nuk vertetohet lidhje midis prodhuesit dhe distributorit pasi sipas saj autorizimi i leshuar nga Lubatex Group eshte autorizim distributori dhe jo autorizim prodhuesi, duke mos sqaruar se ku e mbeshtet kete arsyetim dhe kete arsye skualifikimi.

Lidhur me arsyen e skualifikimit se nuk eshte vertetuar ne dokument lidhja midis distributorit Lubatex Group dhe prodhuesit te baterive te ofertuara konkretish Varta AG sqarojme dhe njehere se nuk ka sesi te vertetohet lidhja ndermjet distributorit Lubatex Group dhe prodhuesit te baterive Varta kur ne fakt dokumenti i paraqitur nga ne nuk ka nevojte per te vertetuar ndonje lidhje sepse eshte Autorizim i prodhuesit ne vetvete si dokument, e konkretisht i Lubatex Group.

Ne kemi paraqitur edhe kataloge te tjere si Freebatt, Energizer, Everkraft, OPTIMA etj, te cilat jane “BRAND” te prodhuara dhe furnizuara per shoqerine tone nga “LUBATEX GROUP”, nderkohe qe AK paraqet si arsye skualifikimi qe nuk vertetohet lidhja ndermjet lubatex Group dhe Varta, kur te gjitha keto brande si edhe Varta jane produkte te prodhuara dhe furnizuara nga Lubatex Group per shoqerine Alstezo, gje e cila vertetohet edhe nga autorizimi i prodhuesit.

Gjithashtu AK mund te bente verifikimet e duhura ne faqen e prodhuesit Lubatex Group dhe do te verente faktin se kjo shoqeri prodhon dhe furnizon shume lloje markash baterish.

AK duhet te kete si synim kryesor dhe paresor te arrije te vertetoje se nje operator ekonomik ka aftesi dhe mundesi disponimi te produkteve te duhura e te nevojshme për realizimin me sukses të kontratës publike objekt prokurimi.

[...]

Si perfundim theksojme se oferta jone i permbush te gjitha kriteret e percaktuara ne dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor dhe kerkojme kualifikimin e ofertes sone.

Ne ankesen e paraqitur prane autoritetit kontraktor ne kemi paraqitur dhe ngritur pretendime edhe per operatoret e tjere ekonomike per klasifikimin ne teresi te operatoreve ekonomike pjesemarres ne kete procedure prokurimi, dhe AK nuk e ka trajtuar fare kete pretendim tonin.

Meqe konstatuam se AK nuk i ka trajtuar ne menyre te barabarte te gjithe operatoret ekonomike pjesemarres ne kete procedure prokurimi gjate shqyrtimit te ofertave, ngritem pretendime edhe per operatoret e tjere prane AK.

AK nuk ka mare ne shqyrtim ankesen tone dhe nuk e ka trajtuar fare kete pretendim, dhe shoqeria jone duke qene se AK nuk eshte thelluar ne verifikimin e plote te gjithe dokumentacionit pa e shqyrtuar ate me profesionalizem kemi dyshimet tona se edhe operatoret e tjere jane kualifikuar pa te drejte, duke shkelur keshtu parimin e trajtimit te barabarte dhe mosdiskriminimin.

Shoqeria jone ka ngritur pretendime prane AK per verifikimin e gjithë dokumentacionit te paraqitur nga operatorët ekonomike te kualifikuar dhe skualifikimin e tyre ne rast mosplotesimi dokumentacioni, duke kerkuar rishikimin e dokumentacionit te tyre, nese i kane plotesuar te gjitha kriteret e vendosura ne DST nga AK.

Ne kushtet kur nga ana e AK nuk eshte bere trajtimi i plote i ankeses sone te paraqitur prane AK, kerkojme ne menyre te detajuar te verifikohet dokumentacioni i paraqitur nga operatorët ekonomike te kualifikuar ne kete procedure prokurimi dhe te behet skualifikimi i tyre per mosplotesim te dokumentacionit te paraqitur.

Autoriteti kontraktor ne vleresimin e ofertave nuk ka respektuar ligjin e prokurimit publik neni 1, 2, 45, 46, 53, 54, 55 etj sepse ka kualifikuar operatorët ekonomike Alked Kopaci, Kadiu dhe Ra-Mi Kompani ne kundërshtim me kete legjislacion, sepse keto shoqeri nuk plotesojne kriteret e percaktuara ne dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor.

Keta operatore kane mangesi ne dokumentacion e per kete duhet te skualifikohen.

Duke qene se jemi nje shoqeri qe operojme ne kete treg per shume vite ne kete fushe, nga informacionet qe kemi pasi jemi pjesemarres ne shume procedura prokurimi te kesaj fushe, dhe duke qene se njohim firmat qe tenderojne ne kete fushe si dhe referuar edhe buletinit te prokurimeve publike kemi indicio se keto firma nuk plotesojne kriteret e peraktuar ne dokumentat e tenderit.

Mendojme se OE e kualifikuar dhe konkretisht Alked Kopaci, Kadiu, Ra-Mi Kompani nuk plotesojne kerkesat e percaktuara ne AK si me poshte:

- nuk vertetojne me dokumentacion sipas kerkesave te AK disponimin e nje mjeti me peshen e kerkuar dhe dokumentacionin e kerkuar sipas kerkesave te AK
- keta operatore ekonomike nuk plotesojne kriteret e percaktuara nga autoriteti kontraktor si me poshte:

6. Operatori ekonomik duhet te provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për këtë objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit te Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, e-mail, Eëbsite kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

7. Operatori ekonomik të paraqesë katalogë/ broshurë të baterive, ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar) Në katalogë/ broshura duhet te markohen (per lehtësi identifikimi) artikujt bateri dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 10 të DST. Katalogët/broshurat duhet të shoqërohen me një listë të baterive sipas tabelës së përgjithshme (shtojca 12) ku të specifikohen të dhënat si vijon:

Nr.	Emertimi i artikullit (Baterisë)	Njësia	Sasia	Emërtimi kompanisë prodhuese	Emërtimi i katalogut	Numri i faqes në katalog	Part-Number i prodhuesit	Standarti i Cilësisë

Keta operatore ekonomike te kualifikuar nuk kane plotesuar dhe nuk vertetojne me dokumentacion kriterin per autorizimin e prodhuesit ose distributorit dhe lidhjen midis tyre, kriter ky per te cilin AK ka skualifikuar dhe shoqerine Alstezo.

Gjithashtu keta operatore ekonomike nuk kane paraqitur kataloget dhe ose broshurat per te gjithë baterite e kerkuara, ku te jene te perfshira sakte dhe korrekt te gjitha elementet e kerkuar ne specifikimet teknike te tyre sipas kerkesave dhe specifikimeve teknike te percaktuara ne shtojcen 10 te DST (edhe ne rastet kur jane te paraqitur disa prej ketyre katalogeve, ato nuk jane te perkthyer ne gjuhen shqipe, te noterizuara, te markuara, te shoqeruara me listen e baterive sipas tabelës së specifikimeve teknike etj.). Kataloget e paraqitur nga keto shoqeri te kualifikuara nuk plotesojne kerkesat e AK, pasi kodet e baterive te ofertuara (referuar Part- Number te tyre) nuk i perkasin baterive te cilat duhet te permbushin te gjitha kriteret e kerkuara ne specifikimet sipas kerkesave te AK. Kerkojme te behet verifikimi i tyre pasi ato nuk jane sipas kriterëve te DST dhe nuk perfshijne te gjitha specifikimet teknike me te gjitha te dhenat dhe elementet e percaktuar ne shtojcen e specifikimeve teknike.

- Certifikatat ISO 9001 dhe 45001 nuk jane te vlefshme dhe nuk jane leshuar sipas percaktimeve te VKM dhe kriterit ne dokumentat e tenderi pasi shoqerite Alked Kopaci, Kadiu dhe Ra-Mi Kompani nuk e kane te lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- nuk kane plotesuar kriterin ne percaktuar ne Shtojcen 9, Kriteret e vecanta te kualifikimit

b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1;

Keta operoret ekonomike nuk e kane dorezuar dhe plotesuar kete deklarate sipas percaktimeve ligjore ne fuqi.

- nuk vertetojne se disponojne te pakten nje ambient magazinimi me siperfaqe minimale 100 m2, me qëllim magazinimin e mallit objekt kontrate, pasi kane mangesi ne dokumentacionin e paraqitur ne perputhje me dokumentat e tenderit, sipas kerkesave te AK

a) (Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

➤ Dokumentacioni qe vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose
- çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huaje.

➤ Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje.

b) Foto të ambientit të magazinimit të mallrave.

Keta operatore ne gjykimin tone kane mangesi ne dokumentacion dhe nuk i plotesojne keto kriterë sipas percaktimeve te AK ne DST, kriterë keto per te cilat AK e ka skualifikuar shoqerine tone dhe duke mos mbajtur nje qendrim dhe nje standart gjate shqyrtimit te ofertave.

Si perfundim kerkojme qe autoriteti kontraktor ne mbeshtetje te parimeve te barazise, mosdiskriminimit dhe transparences te skualifikoje shoqerite me siper si shoqeri me mangesi ne dokumentat e paraqitura ne SPE per kete procedure prokurimi.

Kerkojme qe te behet rivleresimi i procedures se prokurimit nga ana e autoritetit kontraktor duke kualifikuar shoqerine tone si edhe duke skualifikuar shoqerite qe kemi ngritur pretendime .

II.7. Në datën 22.07.2019, nëpërmjet shkresës me nr. 2728/1 prot., datë 16.07.2019, me objekt: “Dërgim informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se arsyeja e skualifikimit “Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 6 të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 9 të DT-së. Dokumenti i datës 21.05.2019 i lëshuar nga “LUBATEX GROUP” për ofertuesin ALSTEZO SHA, është autorizim i lëshuar nga një distributor për këtë procedurë prokurimi, por në këtë rast nuk është vertetuar me dokumentacion lidhja midis distributorit – “LUBATEX GROUP” dhe prodhuesit të baterive të ofertuara, konkretisht ‘VARTA AG’. Në dokumentin e paraqitur si autorizim nuk ka të dhëna të plota të prodhuesit të baterive “VARTA” si tel, email ëëbsite të nevojshme këto në rast verifikimi”, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9, pika 2.3. Kapaciteti teknik, pika 6, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin si më poshtë : “ Operatori ekonomik duhet te provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për këtë objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit te Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, e-mail,ëëbsite kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij”

III.1.2. Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues te ngarkuar ne sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumenti me emërtimin “Autorizim i prodhuesit”, datë 21.05.2019 lëshuar nga Lubatex Group, ku citohet se: “Alstezo sh.a. është një importues dhe distributor i produkteve Lubatex Group për Shqipërinë. Lubatex Group ofron dhe garanton disponueshmërinë e furnizimit të gjithë gamës së artikujve të Lubatex Group për pjesëmarrjen në tenderin që do të mbahet më 05.23.2019 nga Autoriteti kontraktor “Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara” për Lotin Ii, me nr. REF-19847-04-26-2019. Furnizimi do të bëhet nga distributori jonë ekskluziv Alstezo sha në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në këtë procedurë”.

Gjithashtu në këtë dokument konstatohet se në fund të tij është firma dhe vula e Lubatex Group, e cila përmban dhe të dhënat: adresë, numër telefoni, adresë e-maili, etj.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

III.1.4. Në nenin 53, pika 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.5. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

III.1.6. Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “[...] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]”.

III.1.7. Operatori ekonomik ankimes ndërmjet të tjerave pretendon se: “Sa me sipër, ne lidhje me piken 2.3/6 ne plotësim të saj ne kemi paraqitur Autorizimin e prodhuesit dhe jo distributori, sikurse pretendohet nga AK leshuar nga “LUBATEX GROUP” me datë 21.05.2019 pikerisht për këtë procedurë prokurimi.

Ne këtë autorizim janë të evidentuara shumë qarte “te dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, Ëëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij”.

Pasqyrimi i marrëdhënieve të prodhuesit dhe katalogut, shprehet shumë qarte në tabelën e cila është bërë edhe në plotësimin e kriterit në piken 2.3/7 ku thuhet që prodhuesi është “LUBATEX GROUP”, por katalogu është VARTA.

Sqarojme KVO që VARTA në vetevetë nuk është Fabrikë prodhuese, por është një emer (BRAND) baterie, sikurse është Freebatt, Energizer, Everkraft, OPTIMA etj të cilat janë “BRAND” të prodhuara dhe furnizuara tek në nga “LUBATEX GROUP”.

(bashkëngjitur po ju dergojme të ilustruar edhe mënyrën se si mund futeni në faqen Ëëbsite të “LUBATEX GROUP” (ëëë.lubatexgroup.com) nga ku ju mund të shikoni qarte të gjitha markat e trajtuara nga kjo kompani.)

Pra pretendimi i AK për mosplotësim të këtij kriteri nga ana jone NUK QENDRON

Nderkohe, nisur nga gjykimi i mesiperm i KVO-se, lidhur me klasifikimin e ofertave si dhe nga informacionet qe kemi per konkurentet tane te cilet kane ofertuar ne kete procedure prokurimi, nxjerrim konkluzionin se AK nuk eshte thelluar ne verifikimin e plote te dokumentacionit qe ata kane paraqitur se bashku me oferten e tyre ne kete procedure prokurimi, gje e cila ka ndodhur edhe ne rastin e vleresimit te dokumentacionit te paraqitur se bashku me oferten tone ne kete procedure prokurimi.

Perfundimisht bazuar ne Nenin 27 te VKM 914 date 29.12.2014 per Rregullat e Prokurimit Publik i ndryshuar, kerkojme rivleresim te ofertave te OE pjesmarres ne kete procedure prokurimi si dhe riklasifikim nga KVO. Pasi te rishikohet edhe njehere dokumentacioni i tyre, te behet klasifikimi i ofertes tone si nje oferte qe i ka plotesuar te gjitha kerkesat e vendosura nga AK ne Kushtet e Vecanta te Kualifikimit, pika 2.3/6 dhe 2.3/7 per kete objekt prokurimi.

III.1.8. Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, nga ana e operatorit ekonomik ankimues është paraqitur dokumenti Autorizim Prodhuesi, i cili që në krye të shkresës ka emërtimin “Autorizim i Prodhuesit” (Authorization of the Producer), e në brendësi të tij, kompania prodhuese Lubatex Group deklaron se ofron dhe garanton disponueshmërinë e tij për të gjithë gamën e artikujve të Lubatex Group[...]. Gjithashtu Lubatex Group deklaron se furnizimi do të bëhet nga distributori i tyre ekskluziv Alstezo sh.a. në përputhje me specifikimet teknike. Nga ana e operatorit ekonomik ankimues në sistemin e prokurimeve elektronike është paraqitur edhe dokumenti me emërtimin “Lista shoqëruese e katalogëve”, në të cilin është deklaruar emri i kompanisë prodhuese Lubatex Group në kolonën “Emërtimi i kompanisë prodhuese”. Referuar arsyes së skualifikimit të dhënë nga ana e autoritetit kontraktor për këtë procedurë prokurimi, KPP konstaton se dokumenti i paraqitur është autorizim prodhuesi, shoqëria lëshuese e të cilit garanton se do të furnizojë distributorin Alstezo sh.a. me të gjitha produktet sipas specifikimeve teknike. Nga ana tjetër, në këtë dokument evidentohen të gjitha të dhënat e mjaftueshme e të nevojshme të lëshuesit të autorizimit të prodhuesit (adresë, emaili, nr. tel. etj) të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, në bazë të të cilave, autoriteti kontraktor në referim edhe të nenit 53 të ligjit për prokurimin publik mund të bënte të gjitha verifikimet e duhura e të nevojshme. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se operatori ekonomik i kualifikuar “Alked Kopaçi” p.f. nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor në lidhje me mjetin e kërkuar në dokumentat e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se :

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9, pika 2.3. Kapaciteti teknik, pika 3, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

1. *Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transporti mallrash, me peshë mbi 1.5 Ton, me qëllim transportin e mallit, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës, si më poshtë:*

a) *Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:*

➤ *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*

- *Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.*

➤ *Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:*

- *Kontratë huaje.*

➤ *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*

- *Kontratë qiraje.*

b) *Leje qarkullimi e mjetit.*

c) *Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,*

d) *Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,*

e) *Certifikate për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg).*

III.2.2. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

III.2.3. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.2.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike nga operatori ekonomik “Alked Kopaçi” p.f. rezulton se ka paraqitur:

- Dokumenti me emërtimin “Automjeti” ku është paraqitur bashkëlidhur:
- Kontratë qeraje, të lidhur në datën 10.05.2019, ndërmjet shoqërisë “Miell Tirana” sh.a. në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë “Autok Kopaçi” në cilësinë e qeramarrësit, me objekt: Dhënia me qera e mjetit të transportit TR 8977G për një periudhë 3 mujore deri më datë 10.08.2019[...]
- Për mjetin me targë TR 8977G është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:
 - Leje qarkullimi e mjetit
 - Çertifikatë e kontrollit teknik;
 - Siguracioni i mjetit,
 - Çertifikatën për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet

III.2.5. Në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

“[...]

1. Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.
2. Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik
3. Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.
4. Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.
5. Përdorimi nga të tretët përfshin:
 - a) dhënien me qira pa drejtues mjeti;
 - b) dhënien me qira me drejtues mjeti dhe shërbimi taksi për transport njerëzish;
 - c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh;
 - d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të treteve;
 - e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave;
 - f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të treteve.

....

7. Në aktet në zbatim janë përcaktuar karakteristikat konstruktive të mjetit në lidhje me destinacionin ose përdorimet, për të cilat ai mund të caktohet.

8. Duke përjashtuar dispozitat e ligjeve të posaçme, cilido që shfrytëzon një mjet me një destinacion ose për një përdorim të ndryshëm nga ato të treguara në lejen e transportit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë. [...]”

Në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “[...] 3.13. Transport për vete: transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi.

3.14. Transport për të tretë dhe me qira: transporti i mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira. [...]”.

Në nenin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.”

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se *lex specialis*, ligji “Për Transportet Rrugore”, bën qartësisht ndarjen midis certifikatës së lëshuar për “Transport për vete” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet, ku në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi; si edhe certifikatës së lëshuar për “Transport për të tretë dhe me qira” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira. Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se certifikata e mjetit me targë TR8977G të cilën e disponon shoqëria “Mielli” sh.a. sipas lejes së qarkullimit, është specifike dhe e lëshuar vetëm për transport për vete, përmes së cilës është i licencuar vetëm ky subjekt dhe është dhënë në përdorim në emër të personit fizik “Miell Tirana” sh.a., për kryerjen e transportit të mallrave me kamion, brenda vendit, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet.

Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e personit fizik “Alked Kopaçi” të mallrave me kamionët e shoqërisë “Miell Tirana” sh.a. do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për Transportet Rrugore” është i ndaluar.

K.P.P gjykon se licenca e mësipërme është pjesë e dokumenteve të nevojshme që vërtetojnë se mjeti është në përdorim nga operatorët ekonomikë.

Mungesa e licencës së mësipërme, vërteton vetëm faktin se mjeti mund të jetë në pronësi, por përdorimi i tij do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Mungesa e dokumentacionit të mësipërm do të sillte pamundësinë e realizimit me sukses të kontratës, pasi mjetet nuk do të kishin mundësi të qarkullonin.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Alked Kopaçi” p.f. në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues se operatori ekonomik se “operatori ekonomik “Alked Kopaçi” p.f. nuk ka paraqitur kataloget dhe ose broshurat për të gjithë bateritë e kerkuara, ku te jene te perfshira sakte dhe korrekt te gjitha elementet e kerkuar ne specifikimet teknike te tyre sipas kerkesave dhe specifikimeve teknike te percaktuara ne shtojcen 10 te DST (edhe ne rastet kur jane te paraqitur disa prej ketyre katalogeve, ato nuk jane te perkthyer ne gjuhen shqipe, te noterizuara, te markuara, te shoqeruara me listen e baterive sipas tabelës se specifikimeve teknike etj.). Kataloget e paraqitur nga kjo shoqëri e kualifikuar nuk plotëson kërkesat e AK, pasi kodet e baterive të ofertuara (referuar Part- Number të tyre) nuk i përkojnë baterive të cilat duhet të përmbushin të gjitha kriteret e kerkuara ne specifikimet sipas kerkesave te AK. Kerkojme te behet verifikimi i tyre pasi ato nuk jane sipas kriterëve te DST dhe nuk perfshijne te gjitha specifikimet teknike me te gjitha te dhenat dhe elementet e percaktuar ne shtojcen e specifikimeve teknike”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9, pika 2.2. Kapaciteti teknik, pika 7, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

*Operatori ekonomik të paraqesë **katalogë/ broshurë të baterive**, ku të përfaqshihen specifikimet teknike të tyre (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar). Në katalogë/ broshura duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) artikujt bateri dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 10 të DST. Katalogët/broshurat duhet të shoqërohen me një listë të baterive sipas tabelës së përgjithshme (shtojca 12) ku të specifikohen të dhënat si vijon:*

Nr.	Emertimi i artikullit (gomës)	Njësia	Sasia	Emërtimi kompanisë prodhuese	Emërtimi i katalogut	Numri i faqes në katalog	Part-Number i prodhuesit	Standarti i Cilësisë
-----	-------------------------------	--------	-------	------------------------------	----------------------	--------------------------	--------------------------	----------------------

III.3.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Alked Kopaçi” p.f., rezulton se është paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të kriterit të sipërcituar si më poshtë vijon:

- Dokumenti me emërtimin “Katalog”, dokument në gjuhë të huaj dhe i përkthyer noterizuar në gjuhën shqipe;
- Dokument me emërtimin “Oferta Teknike”.

III.3.3. Në nenin 46, pika 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

III.3.4. Në nenin 53, pika 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.3.5. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

III.3.6. Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “[...] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]”.

III.3.7. Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, operatori ekonomik në përmbushje të kriterit për katalogët ka paraqitur dokumentin katalog të përkthyer të noterizuar në gjuhën shqipe, si edhe ofertën teknike me të dhënat sipas tabelës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Nga verifikimi i këtij dokumentacioni konstatohet se ka disa mangësi dhe mospërputhje në lidhje me parametrat sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.3.8. Konstatohet nga verifikimi i dokumentit me emërtimin Skeda teknike, ku janë përcaktuar nga operatori ekonomik “Alked Kopaçi” p.f. të dhënat sipas tabelës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, konstatohet se për disa artikuj janë ofruar produkte me të dhëna për vendosjen e poleve, të ndryshme nga ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit (p.sh. për artikujt me nr. rendor 17, 23, 24, 25, 26, etj.) kanë parametra për të dhënat teknike për vendosjen e poleve të ndryshme nga ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, duke mos përmbushur kështu kriteret dhe specifikimet teknike të hartuara dhe të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

III.3.9. Sa më sipër, KPP sqaron se, mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Operatori ekonomik duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Kadiu” sh.a. në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Alked Kopaçi” p.f., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që i janë pranuar disa prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e përrjedhë duke përmbushur interes e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues se operatori ekonomik se “operatori ekonomik “Kadiu” sh.a. nuk ka plotësuar dhe nuk verteton me dokumentacion kriterin për autorizimin e prodhuesit ose distributorit dhe lidhjen midis tyre, kriter ky për të cilin AK ka skualifikuar dhe shoqerine Alstezo, si edhe nuk ka paraqitur kataloget dhe ose broshurat për të gjithë baterite e kerkuara, ku te jene te perfshira sakte dhe korrekt te gjitha elementet e kerkuar ne specifikimet teknike te tyre sipas kerkesave dhe specifikimeve teknike te percaktuara ne shtojcen 10 te DST (edhe ne rastet kur jane te paraqitur disa prej ketyre katalogeve, ato nuk jane te perkthyer ne gjuhen shqipe, te noterizuara, te markuara, te shoqeruara me listen e baterive sipas tabelës se specifikimeve teknike etj.). Kataloget e paraqitur nga kjo shoqeri e kualifikuar nuk plotëson kërkesat e AK, pasi kodet e baterive të ofertuara (referuar Part-Number të tyre) nuk i perkasin baterive të cilat duhet të përmbushin të gjitha kriteret e kërkuara në specifikimet sipas kërkesave të AK.

Kerkojme te behet verifikimi i tyre pasi ato nuk jane sipas kriterëve te DST dhe nuk perfshijne te gjitha specifikimet teknike me te gjitha te dhenat dhe elementet e percaktuar ne shtojcen e specifikimeve teknike”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.5.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9, pika 2.2. Kapaciteti teknik, pika 6 dhe 7, nga autoriteti kontraktor janë përcaktuar kriteret:

Operatori ekonomik duhet te provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për këtë objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit te Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, e-mail, Eëbsite kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

*Operatori ekonomik të paraqesë **katalogë/ broshurë të baterive**, ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar). Në katalogë/ broshura duhet te markohen (per lehtësi identifikimi) artikujt bateri dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 10 të DST. Katalogët/broshurat duhet të shoqërohen me një listë të baterive sipas tabelës së përgjithshme (shtojca 12) ku të specifikohen të dhënat si vijon:*

Nr.	Emertimi i artikullit (gomës)	Njësia	Sasia	Emërtimi kompanisë prodhuese	Emërtimi i katalogut	Numri i faqes në katalog	Part-Number i prodhuesit	Standarti i Cilësisë
-----	-------------------------------	--------	-------	------------------------------	----------------------	--------------------------	--------------------------	----------------------

III.5.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “ Kadiu ” sh.a., rezulton se është paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të kriterit të sipërcituar si më poshtë vijon:

- Dokument me emërtimin “AP FAAM Bateri”
- Dokumenti me emërtimin “Katalog FAAM Bateri, Përkthyer dhe noterizuar”, dokument i përkthyr noterizuar në gjuhën shqipe;
- Dokument me emërtimin “ Skeda Teknike ”.

III.5.3. Në nenin 46, pika 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

III.5.4. Në nenin 53, pika 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.5.5. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

III.5.6. Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “[...] *aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]*”.

III.5.7. Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, dokumenti me emërtimin “AP FAM Bateri”, është një dokument i cili në përmbajtje të tij ka mungesë të disa elementëve të rëndësishëm që nga ana formale e bëjnë të pavlefshëm këtë dokument. Konkretisht, dokumenti që në krye të tij ka adresën e FAAM; adresën e shoqërisë “Kadiu” sh.a.; datën e lëshimit 20 maj 2019; Drejtuar: Ministrisë së Brendshme- Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara; objektin: Blerje pjesë këmbimi për automjete, për shërbime profilaktike” ndarë në 3 lote – për lotin II “Blerje bateri për automjete” dhe në fund të shkresës është emri dhe pozicioni i personit të shoqërisë që ka lëshuar këtë shkresë, si edhe nënshkrimi. Nga leximi në tërësi i kësaj shkrese, konstatohen disa mangësi e konkretisht, kjo shkresë nuk ka të përcaktuar dhe identifikuar në mënyrë të saktë objektin e prokurimit me fond limit, datë zhvillimi, numër reference. Gjithashtu, ka mangësi të elementëve të cilët janë kërkuar dhe përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, të tilla si: te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, e-mail, Eëbsite kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij (kriter ky i përcaktuar nga vetë autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit).

Akoma më tej kjo shkresë ka edhe mangësi nga ana formale, pasi mungon vula, një element i rëndësishëm në nxjerrjen/lëshimin e një dokumenti/akti/shkrese nga ana e një institucioni apo shoqërie e cila është e pajisur me vulën përkatëse, duke e bërë aktin të pavlefshëm në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative, pasi ka mungesë në formën ose elementët e detyrueshëm të aktit. Sa më sipër analizur, dokumenti i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në përmbushje të kriterit për autorizimin e prodhuesit, ka mungesë të dhënash si email, nr. telefoni, eëbsite etj, të dhëna këto të detyrueshme për t'u përmbushur në respekt të kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit si edhe në respekt të legjislacionit për prokurimin publik në fuqi, si edhe ka mungesë të elementëve që përbëjnë anën formale të dokumentit (vula) element që në mungesë të saj e bëjnë dokumentin të pavlefshëm. Rrjedhimisht ky dokument nuk konsiderohet i saktë dhe operatori ekonomik “Kadiu” sh.a. nuk e përmbush kriterin për autorizimin e prodhuesit.

III.5.8. Në lidhje me pretendimin për katalogët, konstatohet se operatori ekonomik në përmbushje të kriterit për katalogët ka paraqitur dokumentin katalog në gjuhë të huaj dhe dokumentin katalog të përkthyer të noterizuar, si edhe listën me të dhënat sipas tabelës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Nga verifikimi i këtij dokumentacioni konstatohet se ka disa mangësi dhe konkretisht: dokumenti i përkthyer i noterizuar nuk është përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe në tërësinë e tij, por vetëm disa pjesë të katalogut, në kundërshtim kjo me përcaktimin e bërë në dokumentat e tenderit, në pikën 7 të shtojcës 9 ku thuhet se “Operatori ekonomik të paraqesë katalogë/ broshurë të vajra lubrifikant,alkool frenash dhe pastrues motorri, ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre *(të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar)*, Seksionin 4 të dokumentave është përcaktuar se gjuha për hartimin e ofertave do të jetë gjuha shqipe.

III.5.9. Akoma më tej, katalogu i paraqitur ka mungesa në lidhje me markimin e specifikeve teknike, pasi ato nuk janë markuar sipas kërkesës së autoritetit kontraktor të përcaktuar në dokumentat e tenderit. Gjithashtu nga verifikimi i dokumentit me emërtimin Skeda teknike, ku janë deklaruar nga operatori ekonomik “Kadiu” sh.a. të dhënat sipas tabelës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, konstatohet se, disa artikuj, për të cilët është deklaruar part number i prodhuesit, nuk gjenden dhe nuk janë në katalogun e paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, me qëllim verifikimin e specifikeve teknike, në numrin e faqes, të cilën ka përcaktuar vetë operatori ekonomik (p.sh. artikujt me numër rendor 1,2,3). Gjithashtu, konstatohet se, për disa artikuj, të cilët sipas kërkesave të autoritetit kontraktor janë me të dhëna specifike të ndryshme, nga ana e operatorit ekonomik është paraqitur një part number. Për më tepër, nga shqyrtimi i katalogëve konstatohet se disa artikuj/produkte kanë të dhëna e parametra teknike të ndryshme nga ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor, duke mos përmbushur kështu të gjitha të dhënat e parametrat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit (p.sh. artikujt me nr. 25,26,27 etj).

III.5.10. Sa më sipër, KPP sqaron se, mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Operatori ekonomik duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Kadiu” sh.a. në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “ Kadiu ” sh.a., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që i janë pranuar disa prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e përrjedhë duke përmbushur interesat e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

III.7. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Ra – Mi Kompani” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik ankimues ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorit për të cilin paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për operatorët ekonomikë të renditur me vlerë ekonomike më të lartë se vlera e ofertës së tij ekonomike.

Sa mësipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Alstezo” sh.a., mbi ofertën e operatorit ekonomik “Ra – Mi Kompani” sh.p.k., nuk do të merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alstezo” sh.a., për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-19847-04-26-2019, me objekt: “*Loti 2 Blerje bateri për automjete*”, me fond limit 10.405.535,83 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 23.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Alked Kopaçi” p.f. dhe “Kadiu” sh.a. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke i skualifikuar këta operatorë ekonomikë.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Alstezo” sh.a.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1172 Protokolli

Datë 01.07.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Enkeleda Bega	Vilma Zhupaj	Lindita Skeja	Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha